



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna e Vitisë/Opština Vitina/Municipality of Viti
Drejtoria Komunale e Arsimit

KOMUNA E VITISE - OPŠTINA VITINA DREJTORIA E ARSIMIT - UPRAVA ZA OBRAZOVANJE			
29.06.2026			
Regjistri i fëmijëve	Numri-Drej	Shtojcë Prillog	Vlera
05	191/01	-	-



Në bazë të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale neni 62, paragrafi 3 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008; Ligjit nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës, Ligji Nr. 08/L-153 për Edukimin në fëmijërinë e Hershme, si dhe në bazë të neni 4 paragrafi 8, të Udhëzimit Administrativ nr 03/2022 për përfshirjen e Fëmijëve në Institucione parashkollore në Kosovë, Drejtoria Komunale e Arsimit në Viti 29.06.2026 shpall:

K O N K U R S

Për pranimin e fëmijëve në Çerdhen “Gëzimi Ynë” në Viti dhe në paralelet e ndara në fshatin Qifllak dhe në fshatin Drobesh, për vitin edukativ 2026 - 2027
Grupmosha si në vijim:

- 9 muaj – 2 vjeç
- 2-3 vjeç
- 3-4 vjeç
- 4-5 vjeç
- 5-6 vjeç

Konkursi mbetet i hapur nga data: **01.07.2026 -21.07.2026**

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e komunës së Vitisë

Aplikacionet (Formulari i aplikimit) merren dhe dorëzohen në Çerdhen “ Gëzimi Ynë” Viti, çdo ditë pune, duke filluar nga ora: **08:30 – 15:00.**

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Ekstrakti i lindjes së fëmijës (origjinal, jo më i vjetër se 6 muaj);
- Letërnjoftimi i dy prindërve (kopje) ;
- Kontratat e dy prindërve që dëshmojnë se janë në marrëdhënie pune (kopje);
- Kartela e imunizimit të fëmijës-vakcionimit;
- Dëshmi e pagesës së trustit pensional.

➤ **Dokumentet e pa kompletuara nuk do të shqyrtohen.**

Vërjetje:

Institucioni - Çerdhja “ Gëzimi Ynë”në Viti, duhet të veproj konform nenit 4, të Udhëzimit Administrativ me nr.03/2022 për përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë si dhe Ligjit nr.08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme. Duke krijuar grupet përkatëse si dhe duke përcaktuar ecurinë e përgjithshme të regjistrimit, duke respektuar kapacitetet infrastrukture dhe profesionale të institucionit.

Të gjithë aplikuesit që janë me lokacion më të afërt me institucionin parashkollor, pranohen në lokacionin më të afërt, (afërsia zonale - 4 km).

Pas përfundimit të procedurave të konkursit, komisioni për pranimin e fëmijëve përpilon listën e të pranuarve eventual si dhe udhëzon prindërit për plotësim të dosjes së fëmijës së tyre me të dhënat shtesë të cilat dorëzohen në fillim të muajit shtator. Atëherë kur bëhet regjistrimi i fëmijëve,duhet të bashkangjiten edhe këto dokumente:

- Raport për gjendjen e përgjithshme shëndetësore (jo më e vjetër se 2 javë para se të regjistrohet fëmija);
- Analizat mikrobiologjike (strishoja e hundës, fytit, dhe analiza për parazit në zorrë- (jo më të vjetra se 2 javë para se të regjistrohet fëmija).

Datë: 29.06..2026

Drejtoresha për arsim

